

Fuqizimi i Familjes

Ne vitet 2005 - 2007 eshte financuar nga Vodafone Group Foundation. Ç'ËSHTË PROGRAMI I FUQIZIMIT TË FAMILJES? Organizata jonë përqëndrohet tek përkujdesja dhe mbështetja e fëmijëve që kanë humbur ose përballen me rrezikun e humbjes së përkujdesjes së familjes së tyre biologjike. Programet e Fuqizimit të familjes si pjesë përbërëse e SOS Fshatrave të Fëmijëve synojnë të parandalojnë humbjen e përkujdesjes së fëmijëve nga familjet e tyre. Ne i fuqizojmë familjet për forcimin e kapacitetit të tyre në drejtim të mbrojtjes dhe përkujdesjes për fëmijët e tyre si dhe fuqizimit të rrjeteve të sigurisë për fëmijët e pambrojtur dhe familjet e tyre në komunitet. Në rastet kur këta fëmijë kanë humbur familjen e tyre biologjike, ne u sigurojmë përkujdesje me bazë familjen në gjirin e SOS Fshatrave të Fëmijëve.

Qëllimi i Programit të Fuqizimit të Familjes Ne aftësojmë fëmijët, të cilët përballen me rrezikun e humbjes së përkujdesjes së familjes së tyre, që të rriten në një mjedis përkujdesës familjar. Ne punojmë drejtpërsëdrejti me familjet dhe komunitetet dhe i fuqizojmë ato për të mbrojtur dhe përkujdesur në mënyrë efektive për fëmijët e tyre, në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe siguroes të tjerë shërbimesh. Projektet e Programit të Fuqizimit të FamiljesAktualisht, ka 3 projekte të Programit të Fuqizimit të Familjes 1- Projekti Fuqizimi i Familjes, i vendosur në Njësinë Bashkiake nr.2, Sauk, Tiranë2- Projekti Fuqizimi i Familjes, i vendosur në Njësinë Bashkiake, nr.9, Don Bosko, Tiranë3- Projekti Fuqizimi i Familjes, i vendosur në Njësitë Bashkiake 4 dhe 5 në qytetin e Shkodrës

Drejtimi i punës sonë në projekte është administrimi individual i rasteve dhe ndërmarrja e një sërë hapave në mbështetje të fëmijëve. Administrimi i rastit përfshin hapat e mëposhtme:

- Identifikimin e rasteve në bazë të grupit target të përcaktuar për projektin
- Vlerësimin shumëdimensional, të plotë të situatës së fëmijëve në mjedisin e tyre familjar, nëpërmjet dosjes dhe planit individual të ndjekjes dhe zhvillimit
- Planifikimin e shërbimeve dhe ndërhyrjeve
- Ofrimin e shërbimeve fëmijëve, prindërve, kujdestarëve
- Monitorimin periodik dhe rivlerësimin e situatës
- Mbylljen e rastit
- Aktivitetet që kryhen në secilin stad bazohen në parimin e individualitetit dhe në përfshirjen aktive të fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve.
- Punonjësi që ndjek rastin, siguron përmbushjen e të gjitha stadeve të mësipërme dhe bashkëpunimin e një skuadre multidisiplinare duke përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme nga organizata të tjera. Në çdo projekt, mbështeten të paktën 50 familje që janë me probleme sociale dhe ekonomike, ku fëmijët janë në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror. Kohëzgjatja e një familjeje në projekt varion në varësi të problematikave që shfaq.

KUSH JANË FAMILJET DHE FËMIJËT TË CILËT MBËSHTETEN NGA NE?

Ne mbështesim fëmijët në rrezik për të humbur përkujdesin e familjes së tyreFëmijët konsiderohen në rrezik për të humbur përkujdesjen e familjes së tyre, kur nevojat e tyre bazë materiale, emocionale, shëndetësore dhe arsimore nëvleftësohen ose kur fëmijët abuzohen, sepse kujdestarëve të tyre u mungon kapaciteti për të ofruar përkujdesje të mjaftueshme për fëmijët e tyre.

ÇFARË SHËRBIMESH OFROHEN NGA PROGRAMI I FUQIZIMIT TË FAMILJES?Secili program përbëhet nga një paketë shërbimesh për të mbështetur familjet dhe komunitetet për të marrë përgjegjësitë e tyre në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve, si dhe inkurajojmë dhe mbështesim qeverinë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për të pëmbushur detyrimet e tyre në drejtim të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve.

Kjo paketë shërbimesh planifikohet për: 1. Të siguar që fëmijëve u ofrohen shërbimet bazë të nevojshme për të siguar të drejtën e mbijetesës, zhvillimit dhe pjesëmarrjes. Kjo përfshin mbështetjen arsimore, ushqimore, shëndetësore dhe psiko-sociale; përmirësimin e kushteve të jetesës si dhe mbështetjen për të vendosur identitetin e fëmijëve. Këto shërbime akordohen drejtpërsëdrejti për fëmijët. 2. Të mbështetur familjet në ngritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të mbrojtjes dhe përkujdesjes për fëmijët. Kjo përfshin mbështetjen e kujdestarëve për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të tyre prindërore; për sigurimin e burimeve të qëndrueshme (psh. të ardhura dhe ushqim); për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme të zhvillimit të fëmijës si dhe për të administruar burimet e tyre në mënyrë efektive. Këto shërbime u akordohen fëmijëve nëpërmjet familjeve të tyre. 3. Të forcuar sistemet e mbështetjes për fëmijët e pambrojtur dhe familjet e tyre në komunitet.Në mënyrë të veçantë, mbështetja i ofrohet pjesëtarëve të komunitetit (nga grupi i përzgjedhur, ofruesit përkatës të shërbimeve ose pjesëtarët e tjerë të komunitetit) për t'u vetëorganizuar në mënyrë që ata të jenë të aftë për të zhvilluar dhe qenë të gatshëm për të përmbushur nevojat e fëmijëve dhe familjeve të tyre. Këto shërbime u shkojnë fëmijëve nëpërmjet komuniteteve të tyre. Në komunitet, Programi i Fuqizimit të Familjes funksionon për të siguar, që të tre elementët e paketës së shërbimeve akordohen në mënyrë efektive. Megjithatë, shërbimet e veçanta që ofrohen, variojnë nga programi në program dhe nga komuniteti në komunitet, në përputhje me situatat e ndryshme. ARRITJE DHE STATISTIKA TË GJENDEMI PRANË FAMILJEVE PËR TI FUQIZUAR ATO DHE FËMIJËT PËR NJË PËRKUJDESJE CILËSORE…. Statistika 2007

Programi ynë sigurohet që fëmijët dhe familjet të kenë akses në shërbime thelbësore për zhvillimin e tyre të shëndetshëm dhe të plotë.Asistenca dhe ndjekja që ne ofrojmë fokusohet në disa drejtime:

- Mbështetje materiale

Përgjatë vitit 2007, familjeve iu është ofruar ndihmë në bazë të planifikimit individual të nevojave të çdo familje. Familjet suportohen financiarisht për ushqime dhe nevojave për veshje, mjekime, duke patur në kujdes të veçantë fëmijët të cilët mund të jenë në vështirësi fizike apo psikologjike.

- Mbështetje Shëndetsore

Në bazë të nevojave të fëmijëve, prioritet i veçantë i jepet ndjekjes shëndetsore të fëmijëve dhe familjeve në bashkëpunim me qendrat e shëndetit dhe njësitë mjekësore.

- Programe psiko-edukative në mbështetje të nevojave të fëmijëve Gjatë vitit 2007, janë ofruar shërbime psikoedukative pas shkollës duke iu gjendur pranë nevojave të fëmijëve dhe dhënies së mbështetjes në raste të vështirësive akademike të fëmijëve. Veprimtari të tjera të cilat iu janë ofruar fëmijëve janë: kurset e anglishtes, kompjuterit, kurset e pikturës dhe pianos, aktivitete argëtuese dhe shoqërimi i fëmijëve në ambjente dhe aktivitete të tjera. Shkolla Verore 2007

Pjesëmarrja në aktivitete promovuese për të drejtat e fëmijëve

Fëmijët e Programit të Fuqizimit të Familjes marrin pjesë në aktivitetet sociale dhe promovuese për të drejtat e tyre. Një prioritet i fushës sonë është edukimi i fëmijëve për të drejtat e tyre dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të kërkuar të drejtat (lexo më shumë te rubrika “Advokim”)

Mbështetje emocionale

Fëmijëve në Programin e Fuqizimit të Familjes u sigurohet mbështetje psiko-emocionale sipas nevojave dhe vështirësive të tyre. Nëpërmjet teknikave miqësore për fëmijët si lojrat dramatike, ilustrimet, stimulimet, shkrimet e historive, ata mund të shprehin veten, vështirësitë dhe mbështetjen që kërkojnë. Fëmijët, të cilët shfaqin vështirësi të tjera psikologjike në lidhje me të nxënë, vështirësi sjellore apo për shkak të dinamikave familjare konsiderohen për shqyrtim dhe ndërmarrje të hapave profesionale për të garantuar lehtësimin e çështjeve të tyre. Fëmijët me nevoja të veçanta referohen dhe ndiqen në qendra të specializuara profesionale. Familjet fuqizohen në kapacitetet e tyre për tu përkujdesur ndaj fëmijëve të tyre. Familjet nën përkujdesin tonë fuqizohen nëpërmjet marrjes së informacioneve për shërbimet e ndryshme sociale, ekonomike dhe ligjore, ndërmjetësimin për gjetjen e punësimit duke u suportuar me trainime okupacionale, ofrimin të mbështetjes emocionale si dhe ndërtimit të kapaciteteve dhe aftësive të prindërimit. Në këtë drejtim, prindërve, veçanërisht nënat janë mbështetur duke ndjekur kurset e rrobaqepsisë dhe punimeve me dorë.

Trainime për rritjen e kapaciteteve prindërore dhe të fëmijëve

Familjet e Projektet marrin pjesë në trainime dhe organizime të tjera informuese për rritjen e kapaciteteve të tyre. Një prej eksperiencave tona më të mira është organizimi i klasave të prindërimit dhe zhvillimi i tematikave për mirërritjen e fëmijëve, dinamikat familjare, disiplinimin pozitiv, etj.

Bashkëpunim me organizatat dhe aktorët kryesorë Në bashkëpunim me institucione dhe organizata të tjera, ne synojmë të plotësojmë nevojat e familjeve që janë nën përkujdesin tonë, duke iu ofruar atyre ndërmjetësim për punësim, angazhime në komunitet. Në këtë fushë, ne bashkëpunojmë me Njësitë Bashkiake, Qendra Don Bosko, Young Woman Cristian Association, Every Child, Qendra Refleksione, FBSH, etj. Bashkëpunimi dhe partneriteti me aktorë dhe organizata të tjera qëndron në gjetjen e shërbimeve komplementare dhe garantimin e tyre për familjet nën përkujdesjen tonë.

Stafi i Programit të Fuqizimit të Familjes

Stafi i Programit të Fuqizimit të Familjes përbëhet nga punonjës socialë të kualifikuar dhe të mbështetur për rritjen e aftësive për një punë cilësore me familjet dhe fëmijët. Punonjësit socialë të projekteve ndjekin sistematikisht familjet në përkujdesjen e tyre, nëpërmjet vizitave në shtëpi, takimeve të rregullta dhe të planifikuara, gjetjes dhe ofrimin të shërbimeve. Në çdo projekt ka një Koordinator Projekti dhe 1 ose 2 punonjës socialë.

Për më shumë informacion dhe bashkëpunim...

Në qoftë se keni raste fëmijësh dhe familjesh për të rekomanduar kontaktoni...

Elsa Osmani

Pozicioni: Menaxhere Nacionale për Programin Fuqizimi i Familjes

E-mail: elsaosmani@soskd.org.al

Tel: + 355 4 2 378517 / ext 13 Për të lexuar një histori personale klikoni këtu.